



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

V E N D I M

Nr. 50, datë 10/03/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 223, datë 25.11.2021, së z. K.P., ku pretendohet diskriminim për shkak të “orientimit seksual” nga ana e Dr. E.H., me detyrë mjekje familje, pranë Qendrës Shëndetësore nr. 9, Tiranë,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, në datën 01.10.2021, z. K.P. është paraqitur për vizitë mjekësore, me rekomandim të Qendrës “Streha”³, pranë Dr. E.H., me detyrë mjekje familjeje, pranë Poliklinikës nr. 9, Tiranë. Ankuesi pretendon se sjellja e mjekes ndaj tij ka qenë tepër ofenduese. Fillimisht, mjekja nuk e ka lënë të afrohej pranë saj, si dhe në vijim i ka thënë të telefonojë dikë nga Qendra Streha, që të vërtetonte se ishte resident pranë saj. Pasi z. K.P. ka telefonuar Qendrën dhe ka tentuar t’i japë aparatën e tij celular mjekes, kjo e fundit i është drejtuar me ton të lartë, që të mos ia afrojë telefonin, por të përdorë opsionin me zë, që të dëgjojë bisedën.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD;

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Qendra Streha shërben si Qendër Rezidenciale për anëtarët e komunitetit LGBTI.

Në vijim, mjekja nuk e ka lejuar ankuesin të ulet në karrigen përballë saj, duke i thënë se ai vend ishte vetëm për infermierët, si dhe i ka kërkuar kartën e identitetit, të cilën nuk e ka marrë për të parë të dhënat, por ka urdhëruar ankuesin për ta lexuar. Z. K.P. sqaron se është ndjerë tepër i fyer nga kjo sjellje e mjekes, që e ka bërë të ndihet në gabim, edhe pse nuk ka bërë asgjë për t'u ndjerë i tillë. Ankuesi pretendon se nëse do të kishte patur nevojë për shërbim shëndetësor, Dr. E.H. nuk do t'ia kishte ofruar një shërbim të tillë, në kushtet kur ajo nuk prekte me dorë as kartën e tij të identitetit. Për sa më sipër, ankuesi pretendon diskriminim për shkak të orientimit seksual, nga ana e Dr. E.H..

Z. K.P. kërkon nga ana e Komisionerit, marrjen e masave, që Dr. E.H. të sillet profesionalisht me pacientët dhe të mos t'i diskriminojë ata.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “orientimit seksual” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 223, datë 25.11.2021, së z. K.P., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Dr. E.H., me detyrë mjeke familje, pranë Qendrës Shëndetësore nr. 9, Tiranë, si dhe për dijëni ankuesit dhe Qendrës Streha⁵, me shkresën nr. 1629/1, datë 06.12.2021, ku kërkohej informacion, mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1629/1, datë 06.12.2021, së KMD-së, Dr. E.H. dërgoi shkresën nr.1629/2, datë 15.12.2021, ku sqaron se në kushtet e pandemisë Covid -19 është

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

⁵ Shkresa në fjalë iu dërgua me email Qendrës Streha, pasi nga KMD nuk administrohej asnjë adresë e saj.

e nevojshme zbatimi në mënyrë rigoroze i masave anticovid të tilla si: distanca e duhur midis njerëzve, maska, higjiena etj.

Ajo thekson faktin se pacienti K.P. ka patur akses në zyrën e saj dhe nuk është mbajtur në distancë dhe është ulur tek krevati i posaçëm i vizitave për pacientët. Znj. E.H. sqaron se pacientit i është kërkuar karta e identitetit, sikurse të gjithë pacientëve të tjerë, me qëllim që të verifikohet në kompjuter, nëse janë të regjistruar në sistem, për t'u lëshuar rekomandime apo vizita. Kjo pasi çdo veprim kryhet elektronikisht. Dr. E.H. thekson faktin se ajo është mjekja që viziton pacientët që janë banorë të Njesisë Administrative nr. 7, por përjashtim bëjnë rastet e përcjella nga Shoqata e Viktimave të Trafikimit dhe Dhunës si dhe Qendrës Streha. Pacientit i është kërkuar për lehtësi veprimi të lexojë të dhënat e kartës së identitetit, me qëllim që gjatë leximit, mjekja të kryente verifikimin përkatës në sistem. Ajo shprehet se shpesh herë leximin e kartave të ID ua kërkon pacientëve, pasi nga lodhja e ditës, shikimi i shkronjave bëhet i vështirë për të. Ndërkohë që, është folur me vivavoce me Qendrën Streha për të konfirmuar nëse pacientit i ofrohet shërbim nga kjo qendër, pasi në të kundërt, nëse ai nuk do të ishte banor i njesisë administrative përkatëse, z. Klemi do të duhej të paraqitej pranë Qendrës Shëndetësore përkatëse për të marrë shërbimin e duhur shëndetësor. Dr. E.H. shprehet gjithashtu që mundohet të evitohet prekjen e sendeve personale të pacientëve me qëllim mos rrezikimin e tyre. Në këtë kontekst, ajo shprehet se ankuesi nuk mund të bëjë supozime dhe as ta paragjykojë për një gjë të tillë, pasi ajo e ka lejuar të marrë shërbim edhe pse ishte i papajisur me maskë dhe i ulur në krevatin e pacientëve pranë tavolinës së saj. Njëkohësisht, mjekja sqaron se çdo pacient akomodohet tek krevati i posaçëm i vizitave dhe jo tek karrigia përballë tavolinës së saj, pasi aty qëndron infermierja që plotëson regjistrin e vizitave, ku hidhen të dhënat e pacientëve. Mjekja shprehet se në punën e saj ajo nuk është e interesuar për statusin social, ekonomik apo edhe mbi orientinin seksual të pacientëve. Ajo sqaron se po të kishte patur problematika me personat që kanë orientim të ndryshëm seksual, ajo nuk do të pranonte t'u ofronte shërbim personave që trajtohen nga Qendra Streha, pasi ky shërbim u ofrohet me mirëbesim, pa patur asnjë marrëveshje të shkruar dhe pa e patur detyrim në kuadër të përcaktimeve të kontratës së saj të punës.

- Qendra Streha nuk i ktheu përgjigjie shkresës së KMD-së.
- Për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 25.02.2022, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi dhe përfaqësuesja e Qendrës Streha, si dhe ankuesja E.H.. Ankuesi parashtroi edhe një herë pretendimet e tij, lidhur me sjelljen e mjekes ndaj tij në muajin tetor 2021, kur ai ishte paraqitur pranë Qendrës Shëndetësore nr. 9. Ai sqaroi se ishte paraqitur pranë Dr. E.H., me qëllim ndërrimin e mjekut të familjes. Kjo ishte një procedurë e zakonshme për ata banorë të Qendrës Streha që vendbanimin e tyre e kishin në rrethe të tjera, pasi

ishin të detyruar të paraqiteshin për të ndërruar mjekun e familjes që i kishte ndjekur në vendbanimin e tyre. Mjekja E.H. sqaroi se në asnjë rast sjellja e saj nuk ka patur tendencë për të diskriminuar ankuesin, për shkak të orientimit seksual . Ajo u shpreh se i ka ofruar shërbim mjekësor të gjithë personave, që banojnë në Qendrën Streha dhe janë paraqitur me rekomandim të kësaj qendre. Ajo, në asnjë rast nuk ka refuzuar shërbimin ndaj tyre dhe nuk i ka diskriminuar për shkak të orientimit seksual. Megjithatë, Dr. E.H. u shpreh se nëse sjellja e saj e kishte lënduar ankuesin, ajo i kërkon ndjesë publikisht në sy të të gjithë të pranishmëve në këtë seancë dëgjimore. Ndjesa e saj u kërkuar në mënyrë të përsëritur ndaj ankuesit.

Dr. E.H. u shpreh se sjellja e saj nuk ka qenë asnjëherë diskriminuese, për shkak të orientimit seksual, jo vetëm ndaj z. K.P., por ndaj të gjithë personave që banojnë në Qendrën Streha dhe paraqiten për të vizitë mjekësore pranë saj. Ajo theksoi faktin se profesioni i mjekut është në vetvete i tillë, pasi u ofron shërbim mjekësor të gjithë individëve në nevojë, pavarësisht orientimit seksual apo shkaqeve të tjera të parashikuara në LMD, të ndryshuar.

Në vijim të seancës dëgjimore, z. K.P. u shpreh se tërhiqej nga ankesa dhe se qëllimi, për të cilin ishte filluar shqyrtimi administrativ i ankesës është arritur.

- Z. K.P. dërgoi pranë KMD-së, e-mailin e datës 01/03/2022, nëpërmjet së cilit kërkon të tërhiqej nga ankesa, pasi qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ i KMD-së, ishte arritur.
- Në këto kushte, Komisioneri gjykoi se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Dr. E.H. ka shprehur keqardhjen e asaj për mënyrën se si ankuesi ka perceptuar sjelljen e saj dhe ka theksuar faktin se në asnjë rast nuk ka patur si qëllim diskriminimin e ankuesit dhe asnjë personi tjetër, banues ose jo pranë Qendrës Streha, për shkak të orientimit seksual. Gjithësesi, ajo ka kërkuar në mënyrë të përsëritur ndjesë ndaj ankuesit, ndjesë e cila në vetëvete i atribuohet çdokujt që mund të ketë perceptuar në mënyrë të ngjashme një trajtim të tillë.

Në këto kushte, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*⁶, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

⁶ Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikon: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 223, datë 25.11.2021, së z. K.P., për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe shërbime
Shkak – orientimi seksual
Lloji i vendimit – arritje efektiviteti